



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 6114/Prot.

Tiranë, më 30.4.2025

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Nr. 43 Datë 30.4.25

PËR

ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE" SHA TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 71, datë 17.10.2019 "Për Korporatën e Investimeve Shqiptare", Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", Aktit Normativ Nr. 3, datë 29.04.2025 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025" dhe Urdhrit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Nr. 600, datë 30.04.2025 "Për transferim fondi", me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Korporata e Investimeve Shqiptare" sha Tiranë;

VENDOSA:

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë "Korporata e Investimeve Shqiptare" sha, Tiranë për vlerën 867,200,000 lekë, e barabartë me vlerën e 10 milionë USD sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 29.04.2025, kaluar me Aktin Normativ Nr. 3, datë 29.04.2025 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", për financimin e projektit të investimit "Pjesëmarrja e Qeverisë Shqiptare e përfaqësuar nga Korporata e Investimeve Shqiptare në start-up-in "Thinking Machines Lab".
2. Bazuar në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit" ngarkohet Shoqëria "Korporata e Investimeve Shqiptare" sha Tiranë, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

